



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1842/1 Prot.

Tiranë, më 28 / 12 / 2020

V E N D I M

Nr. 183, Datë 28 / 12 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 66, datë 06.07.2020, të H.Rr kundër Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “Në datë 20.01.2020 bashkë me bashkëshorten ka udhëtuar drejt shtetit Grek për të vizituar djalin. Për shkak të mbylljes së kufijve si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19, nuk kanë mundur të kthehen në Shqipëri në muajin mars, duke mos respektuar afatet kohore për të qëndruar në vendet e hapësirës Schengen. Me daljen e urdhërit për hapjen e kufijve, në datë 18.06.2020 kanë udhëtuar drejt pikës kufitare të Kakavijës. Në pikën doganore të Greqisë janë gjobitur me shumën nga 1200 euro për person. Ankuesi informon se për shkak të gjendjes ekonomike, pasi të dy bashkëshortët janë pensionitë¹, e ka të pamundur që të paguajë gjobën dhe pastaj të

¹ Referuar Vërtetimit nr. 1937 dhe nr. 1938, datë 01.07.2020 të Drejtorisë Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Elbasan, F.Rr përfiton pension pleqërie në masën 9811 lekë dhe kompensime 2565 lekë, ndërsa H.Rr përfiton pension pleqërie në masën 13245 lekë dhe kompensime 1288 lekë.

rimburohet sipas parashikimit në Vendimin Nr. 474, datë 15.06.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”. Ankuesi shprehet se vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave, nuk ka marrë parasysh personat që nuk kanë asnjë mundësi ekonomike të paguajnë paraprakisht gjordat dhe më pas të përfitojnë rimbursim. Ankuesi shprehet, se mospagesa e gjordës i heq të drejtën atij për të udhëtuar drejt shtetit Grek, në të ardhmen”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 66, datë 06.07.2020 të H.Rr u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

1. Me shkresën nr. 917/1, datë 10.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Me shkresën nr. 917/2, datë 18.08.2020 “Kujtesë për shkresën nr. 917/1, datë 10.07.2020”, Komisioneri ka kërkuar përsëri informacion nga Këshilli i Ministrave lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

Me shkresën nr. 3539/2, datë 27.08.2020, Këshilli i Ministrave, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pretendimi i ankuesit është i pabazuar, për arsyet si vijon: Parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit gjejnë trajtim të gjerë si në të drejtën vendase, ashtu edhe në atë ndërkombëtare. Këto parime kanë aspektin formal, për shëmbull, trajtimin koherent nga ligji të të gjithë personave dhe aspektin material, për shëmbull ndarjen e barabartë të të drejtave dhe përfitimeve në një shoqëri të caktuar. Jurisprudenca kushtetuese shqiptare, në referim të standarteve të vendosura nga jurisprudenca ndërkombëtare, ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, duke u shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta (Vendimet nr. 16/2000, nr. 20/2006 e nr. 17/2010 të Gjykatës Kushtetuese)”. Sipas kuptimit të nenit 14 të KEDNJ-së, nocioni i diskriminimit përfshin në përgjithësi çështjet kur një individ ose një grup trajtohet, pa justifikim të përshtatshëm, më keq se një tjetër, edhe pse Konventa nuk kërkon trajtim më të favorshëm. Për shkak të situatës jo të zakonshme të shkaktuar nga Covid-19, me qëllim zvogëlimin e pasojave të përhapjes së infektimit, në shumë vende të botës, përfshirë dhe Shqipërinë, në përrputhje me legjislacionin në fuqi, një seri të drejtash u kufizuan, përfshirë lirinë për të lëvizur lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit apo jashtë tij. Pas lajmit të bërë publik, se disa shtetas shqiptarë që kanë tejkaluar afatin e qëndrimit jashtë Republikës së Shqipërisë, për shkak të mbylljes së kufijve si pasojë e gjendjes së shkaktuar nga Covid-19, janë gjobitur nga këto shtete, qeveria shqiptare u zotua se, në rast se autoritetet e shteteve të huaja nuk do të anulojnë gjobën, qytetarët shqiptarë do të rimbursohen në masën 100% nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Ky zotim i qeverisë shqiptare u konkretizua përmes miratimit të VKM-së nr. 474, datë 15.06.2020 “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, i cili parashikon rimbursimin e gjobave të shtetit grek në ngarkim të rreth 175 shtetasve shqiptarë, dhe përballimin e efektit financiar të përlogaritur prej 26.000.000 lekësh, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020. Këshilli i Ministrave ngarkoi Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi. DPT-ja publikoi në faqen zyrtare njoftimin për rimbursimin e gjobave të vendosura shtetasve shqiptarë, jashtë RSH-së si pasojë e situatës së shkaktuar nga Covid-19, ku ndër të tjera, në përrputhje me VKM-në 474/2020, rikujtoi detyrimin (e njëjtë), për çdo individ e subjekt, të dokumenteve dhe të dhënave që duhet të disponojnë për efekt të rimbursimit. Për sa më lart, VKM-ja nr. 474/2020, nuk ka bërë asnjë dallim për sa i përket trajtimit të subjekteve përfituese, pasi këto subjekte trajtohen të gjithë njëjloj, duke parashikuar kushte të njëjta të përfitimit të rimbursimit, në përrputhje me ligjin 10221/2010”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 66, datë 06.07.2020, Komisioneri me shkresën nr. 1617, datë 23.11.2020 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 02.12.2020, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Shpjegime nëse gjatë hartimit të projektvendimit të Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”, është marrë parasysh niveli i të ardhurave dhe aftësia pague e popullsisë në vend, kur është parashikuar se lehtësitë e ofruara nëpërmjet aktit përkatës të jenë efektive dhe të mund të gëzohen në baza të barabarta, pavarësisht nga gjendja ekonomike e personave.
 - Shpjegime mbi arsyet që kanë shërbyer për marrjen e vendimit për rimbursimin e gjobave të vëna nga autoritetet e shteteve të huaja nga ana e Këshillit të Ministrave.
 - Shpjegime mbi qëllimin që ka synuar të arrijë Këshilli i Ministrave nëpërmjet marrjes së vendimit për rimbursimin e gjobave.
 - A ka pengesa, dhe nëse po, cilat janë ato, që nuk lejojnë pagesën e gjobës në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga ana e institucioneve shtetërore, për të shmangur në këtë mënyrë pengesat që mund të lindin, për personat për shkak të gjendjes ekonomike dhe paaftësisë së tyre pague.
 - Kopje të relacionit shpjegues për projektvendimin “Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë”.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues i përfaqësuar me deklaratë nga G.S dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, S.M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Përfaqësuesi i subjektit ankues theksoi dhe njëherë faktin se parashikimi i bërë në VKM-në objekt i shqyrtimit, lidhur me rimbursimin e gjobës, e ka vendosur H.Rr, në një situatë diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike.

Përfaqësuesi i MFE-së deklaroi se, akti në shqyrtim nuk është një akt rregullator por është një mbështetje financiare që i është bërë shtetasve Shqipëtarë për shkak të vendosjes së gjobës nga autoritetet e shteteve të huaja, si pasojë e mbylljes së kufijve pas gjendjes së krijuar nga COVID-19. Gjithashtu, përfaqësuesi i MFE-së theksoi faktin se në aspektin ligjor nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të kryer rimbursimin përveç asaj mënyre që është shkruar në aktin në shqyrtim, pasi

Këshilli i Ministrave e ka të pamundur ligjërisht që të paguajë gjobën e një individi në një shtet tjetër.

Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1687, datë 03.12.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka kërkuar informacion lidhur me numrin e personave që kanë aplikuar për të përfituar nga zbatimi i VKM-së 474/2020, që nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM-së dhe deri në datë 03.12.2020 dhe numrin e personave që janë rimbursuar apo janë në proces rimbursimi.

Me shkresën nr. 23453/1, datë 10.12.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Deri në datë 09.12.2020 kanë aplikuar pranë DPT-së, 190 individë për tu rimbursuar sipas VKM-së nr. 474, datë 15.06.2020, nga të cilët kanë paguar gjobën 119 individë. Nga këta, 84 individë janë rimbursuar, 15 individëve iu është refuzuar kërkesa për mosplotësim të kriterëve ligjore, 7 individë janë në proces rimbursimi dhe 13 individë janë njoftuar për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar. Kërkesa për rimbursim e H.Rr është trajtuar nga ana e DPT-së dhe është rimbursuar gjoba në datë 27.10.2020”.*

Me e-mail-in datë 17.12.2020, subjekti ankuesi ka paraqitur një deklaratë me shkrim me anë të së cilës ka deklaruar se tërhiqet nga çështja për arsye se ka shlyer gjobën dhe nuk ndodhet më në kushtet që ndodhej kur ka paraqitur ankesën.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi H.Rr, i cili me anë të deklaratës së datës 17.12.2020 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 66, datë 06.07.2020, të paraqitur nga ankuesi H.Rr kundër Këshillit të Ministrave.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA